



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21. 1. 2020 Ora 18:30

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e Konventës së Minamatës “Për merkurin””.

(Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Robert Bitri, Andrea Marto, Ilir Ndraxhi, Eglantina Gjermani, Ardit Konomi, Arben Pëllumbi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Halit Valteri, Nimet Musaj, Kujtim Gjuzi, Klajdi Qama, Edmond Leka dhe Zef Shtjefni.

Mungojnë:

Lefter Koka, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja dhe Tatiana Nurçe.

Të ftuar:

Ornela Çuci –Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Klodiana Marikaj – Përfaqësuese nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Lindita Tafaj – Instituti i Shëndetit Publik

Nexhila Kodra – Përfaqësuese nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Miranda Daja – Përfaqësuese nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Niko Peleshi – Mirëmbërëma!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese. Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë projektligjin “Për ratifikimin e konventës së Minamatës “Për Mërkurin””. Relator i këtij projektligji është zoti Besnik Baraj. Të ftuar nga Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit kemi zonjën Ornela Çuçi, zëvendësministre dhe zonjën Klodiana Marikaj.

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale kemi të ftuar zonjën Lindita Tafaj, e cila është duke ardhur, zonjën Nexhila Kodra dhe zonjën Miranda Daja.

Po ia kaloj fjalën zotit Baraj dhe pastaj përfaqësuesve të ministrive relevante.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Unë e vlerësoj relatorin ose relatoren që ka përgatitur materialin! Duket që është vërtetë profesionist dhe që ka punuar në këtë fushë. Dua të shtoj disa vlerësime për zanafillën e përcaktimeve të mërkurit. Nuk janë shumë të sakta, sepse metoda e avujve të ftohtë për përcaktimin e mërkurit ka filluar në mesin e viteve '80. Ka qenë rastësi që unë kam punuar bashkë me disa kolegë, ku më i spikaturi ka qenë profesor Alqi Çullaj, që është marrë me këtë. Njëkohësisht kanë filluar shumë studime të tjera në ato vite dhe në fillim të viteve '90, kur është bërë vlerësimi i merkurit në biod, sedimente dhe në ujë. Ajo që unë do të theksoj për kolegët këtu është një fakt që nuk është përmendur.

Minamata është një zonë në Japoni ku rreth viteve '50 – '56 ka ndodhur një aksident, ku njerëzit janë ekspozuar ndaj merkurit nëpërmjet ushqimit që përdornin, peshku, që e kishin ushqim të përditshëm. Ka pasur raste vdekjesh dhe njëkohësisht edhe deformime të ndryshme në sistemin nervor, por edhe në lindjet që janë bërë atje. Që nga ajo kohë është quajtur sëmundja e Minamatës për të gjithë ata njerëz që janë të ekspozuar ndaj përqendrimeve të larta të merkurit. Në Universitetin e Tiranës, në katedrën e Kimisë Analitike, ka një përvojë jashtëzakonisht të madhe dhe të pasur në lidhje me përcaktimin e merkurit në ekosisteme të ndryshme. Unë do të thosha që në këtë projektligj do të ishte mirë që bashkëpunimi me institucionet shkencore dhe Universitetin e Tiranës të jetë sa më intensiv për të pasur një përfundim sa më profesional dhe një përfitim sa më të mirë nga ratifikimi i kësaj konvente.

Çuditem si është e mundur që nuk është ratifikuar më parë, kur Shqipëria me të vërtetë ka dhënë kontribute. Ajo që do të sugjeroja dhe që e thashë pak më parë është që të ketë vazhdueshmëri në këto vlerësime dhe konsistencë në rezultate, sepse ka fragmentarizim në vlerësimet në vite të ekosistemeve të ndryshme. Institucionet qendrore shpeshherë nuk ngarkojnë

institucionet e duhura shkencore për t'u marrë me këto punë, por ua lënë subjekteve që nuk janë të përgjegjshme ose nuk kanë profesionalizmin e duhur. Për këtë arsye unë mendoj, se qoftë instituti i Lindës, qoftë Fakulteti i Shkencave të Natyrës, duhet të bëhen patjetër pjesë në përfshirjen e të gjitha projekteve që parashikon kjo konventë dhe përfitimet që mund të ketë Shqipëria nga kjo. Mund të jetë një nxitje dhe ecje përpara nëpërmjet aktivizimit të këtyre institucioneve shkencore.

Ju ftoj ta miratojmë, sepse përfitimet janë shumë më të mëdha sesa pagesa simbolike që vendi ynë do të bëjë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zonja Çuçi.

Ornela Çuçi – Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Në fakt profesori e prezantoi shumë herë më mirë se çdo ta bënte secili prej nesh, sepse është profesor i fushës. Profesor, ju keni të drejtë, por është punuar përmes PNUD-it. Që në vitin 2014 është marrë një vendim i Këshillit të Ministrave për ratifikim në parim të kësaj konvente, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2017. Përmes *Global Environment Facility* Just është marrë një projekt, i cili ka funksionuar në bashkëpunim me ministrinë tonë dhe Institutin e Shëndetit Publik në vendin tonë përmes PNUD. Në këtë mënyrë kemi ardhur në këtë dokument, i cili është ligji kuadër për ratifikimin e Konventës së Minamatës.

Janë 128 vende që aderojnë në konventë, nga të cilat 105 prej tyre e kanë ratifikuar aktualisht. Ne jemi një nga vendet që pritet ta ratifikojmë. Në fakt jemi në momentin e përshtatshëm për ta ratifikuar përmes një ligji, sepse sivjet *Global Environment Facility* e ka shpallur këtë vit si supervitin e Konventës së Minamatës dhe e zbatimit të saj, të ndihmuar në këtë mënyrë me një portofol të veçantë me projekte për të gjitha vendet që e ratifikojnë ose e kanë ratifikuar këtë konventë për të ndihmuar në zbatimin e legjislacionit përkatës. Ky legjislacion që ju sot keni përpara është kuadri ligjor i politikave dhe rregullator me qëllim përcaktimin e kërkesave për zbatimin e kësaj konvente. Në këtë kuadër janë analizuar të gjitha aktet nënligjore, të cilat lidhen me përdorimin e merkurit dhe është përgatitur raporti mbi analizën e boshllëqeve legjislative që ne kemi aktualisht për këtë çështje.

Bazuar në këtë projekt është përgatitur me ndihmën e Institutit të Shëndetit Publik edhe inventari se çfarë po ndodh aktualisht në vendin tonë, ku identifikohen të gjitha burimet e

gjenerimit të merkurit përmes këtij inventari kombëtar të merkurit së bashku me aktivitetet dhe sasitë tepër të tyre dhe cilët janë sektorët që përdorin merkurin, sasitë përkatëse të përdorimit, si dhe shkarkimet e merkurit në vendin tonë. Gjithashtu, është përgatitur edhe një plan kombëtar dhe masat prioritare të merkurit për mënyrën e zbatimit të gjithë këtij kuadri ligjor. Për herë të parë kemi projektvendimin “Për miratimin e rregullave të ndalimit të eksportit të merkurit metalik komponimeve dhe disa përzierjeve të merkurit për ruajtjen e sigurt të merkurit metalik, si dhe kriteret specifike për ruajtjen e merkurit metalik të konsideruar si mbetje”.

Ju ftoj ta miratojmë këtë konventë. Është një nga konventat që ende nuk e kemi miratuar. Në fakt, ka shumë kohë që ka kaluar nëpër dosje, por është e domosdoshme në këtë moment, edhe për arsye të një mundësie më të mirë në vendin tonë për thithjen e këtyre lloj projekteve.

Kam vetëm një fjali dhe do ta mbyll.

Sot për merkurin në Shqipëri ka vetëm një problem me mbylljen e PVC-së në Vlorë, që është evidentuar që në vitin '92. Janë disa projekte që e kanë evidentuar këtë, qoftë edhe duke matur nivelin e mërkurit të peshqit apo tek individët. Kjo është evidentuar (nëse duhet si kuriozitet) me anë të qimeve të flokëve në mbi 30 persona, ku është evidentuar se 6 prej femrave të analizuara kanë pasur nivele 4 herë më të larta se normat e merkurit në gjakun e tyre, që përben një problem realisht të madh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për shkak të fabrikës që ka qenë, për shkak të PVC-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

400 kilogramë.

Besnik Baraj – Në përgjithësi rajoni ynë në Europë ka vetëm 2 miniera mërkuri, njëra është në Slloveni, që është e mbyllur, tjetra në Spanjë. Të paktën kaq di unë.

Deti Adriatik në përgjithësi ka qenë i ekspozuar ndaj përqendrimeve relativisht të larta të mërkurit, veçanërisht në grykëderdhjen e lumit Po, ku është gjetur përqendrimi më i lartë në sedimente, për shkak të shkarkimeve industriale. Pra, mërkuri përdoret në industri të ndryshme, ndërsa në Shqipëri ne kemi sodën e Vlorës, që tha... Vaskat ku bëheshin elektrolizat e sodës, ku çlirohej klor dhe përfitohej sodë kaustike, kanë qenë prej merkurit. Aty ka pasur rreth 70 tonë mërkur dhe kur janë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...hapur vaskat janë gjetur rreth 40 tonë. 30 tonë janë shkarkuar në gjirin e Vlorës, një pjesë është evaporimi apo avullimi i saj.

Nga pikëpamja kimike mërkuri është jashtëzakonisht inert dhe ai “fle”, si të thuash, aty. Megjithatë, në specie të ndryshme, për shkak të reaksioneve shpeshherë katalitike, ndodh që mërkuri, që nuk është biodisponibël, transformohet në disa forma që janë biodisponibël, që është metil-etil-mërkuri. Te peshqit zakonisht 80-90% e përmbajtjes së mërkurit ndodhet deri në 95 % në format e etil dhe metil mërkurit, që janë jashtëzakonisht toksike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, në përgjithësi te peshqit grabitqarë është gjithmonë në zinxhirin ushqimor. Metalet e rënda janë më të mëdha. Shpeshherë mjekët, vite më parë, jo tani (që në vitet '70 kam ndeshur artikuj në Suedi), thoshin se u rekomandohet grave që në periudhën e shtatzënisë të mos përdorin peshq, pra të mos e kenë frekuent në ushqimin e tyre, sepse mund të shkaktojë problematika në fetus.

Eglantina Gjermeni – Vazhdon ky rekomandim.

Besnik Baraj – Sigurisht.

Ka një gjë: përcaktimi i mërkurit te peshqit, meqenëse peshqit janë të lëvizshëm, nuk karakterizon dot pjesën dhe vendin. Shpeshherë për karakterizimin e nivelit të ndotjes së zonave stacionare, siç është gjiri i Vlorës, përdoren midhjet dhe ndërkombëtarisht është një projekt që ka filluar në vitet '70 dhe quhet *masel watch*, që është *mytilus galoprovincialis*, që e kemi edhe ne. Në këtë mënyrë mund të bëhet edhe krahasimi i shkallës së kontaminimit të midhjeve në detin Adriatik, për shembull, me midhjet në rajone të ndryshme të botës. Nuk është për t'u alarmuar dhe për t'u shqetësuar në kuptimin... Në përgjithësi ka një monitorim apo një vlerësim. Shqipëria i ka kapacitetet për të bërë vlerësimin, analizat kimike të mërkurit te biot, algat, bimët në ujë dhe sedimentet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, bëhet.

Ka pasur shumë projekte për rehabilitimin e zonës së Vlorës, një pjesë është inkapsuluar, veçanërisht Petrolifera ka luajtur një rol aty. Ka pasur një projekt çek, që e nxirrte mërkurin nga rëra, duke e kaluar në një sistem. Kjo ka ndodhur vite më parë. Pra, projektet aty kanë qenë pa fund. Megjithatë, gjithmonë ato zona duhen monitoruar. Në përgjithësi, edhe ne, po të marrim të analizojmë flokët (kush ka mbushje mërkuri), do të gjejmë nivele të caktuara të mërkurit në

flokë, sepse në flokë mercuri përqendrohet në nivele të tilla që mund të kapen nga pikëpamja analitike. Pra, është brenda këtyre limiteve të zbulimit. Në Vlorë janë bërë studime. Edë, për shembull, mund të ketë më shumë, sepse ha më shumë peshk.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Studimet e përcaktimit në gjak dhe në flokë të banorëve dhe punonjësve të sodës janë bërë që në vitet '80 dhe janë gjetur nivele... Po kështu, të plumbit në Berat, për shembull, të atyre që punonin te fabrika e baterive e të tjerë. Pra, gjithçka është nën kontroll.

Këtu kemi një eksperte shumë të mirë (mbaj mend që ka qenë një studente shumë e mirë, një studente e notës 10), Lindën, dhe, si të thuash, është në duar shumë profesionale përgjegjësia për të kryer analizat kimike dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Votimi patjetër, sepse ne nga kjo mund të marrim projekte, institucionet që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ornela Çuçi – Aktualisht, UNEP është duke implementuar një projekt shumë të madh për gjithë Mesdheun, që quhet UNEP Mad. Një nga disa nënprojektet që ata zbatojnë prek pikërisht konventën e Minamatës. Në gjithë rajonin e Mesdheut janë fokusuar vetëm në Bosnjë, sepse raportohet për nivele shqetësuese të merkurit, ndërkohë që nga Shqipëria nuk vijnë raporte të tilla. Po të na analizosh të gjithëve, ne duhet të shohim se kush ha më shumë peshq të egër, sepse ata që hanë më shumë peshq të egër duhet të kenë më shumë nivele mercuri, sepse ata që hanë peshqit e rezervuarit sigurisht që nuk kanë. Kështu që, varet nga kjo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj – Edhe me një sens humori, por është edhe e vërtetë, njerëzit që pinë alkool në masë të moderuar e nxjerrin merkurin nga organizimi. Pra, ka edhe efekt...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më dëgjoni!

Niko Peleshi – Mirë që jemi pa medie.

Besnik Baraj –Kjo është e vërtetë, është e provuar edhe shkencërisht.

Ka një zonë në veri të Brazilit, në Rio Grande, që është shumë e pasur me merkur. Kam qenë në një konferencë dhe u bë pyetja se si ishte e mundur që banorët ishin të ekspozuar, sepse ushqeheshin me peshq, zona ishte e tillë dhe gjeologjia kishte merkur. Përgjigjja ishte se përdornin shumë alkool, pinin shumë alkool dhe kjo ishte një...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është e vërtetë.

Edmond Leka – Kam vetëm një pyetje, meqenëse jam i ndjeshëm për atë zonë, sepse është zona elektorale që mbuloj, Besnik. Sa kohë do ajo zonë të rehabilitohet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj –Më fal, një minutë!

Në qoftë se ti e inkapsulon atë, se mercuri në përgjithësi nuk është shumë aktiv nga pikëpamja kimike, qëndrimi në formë si merkur metalik, vetëm në qoftë se ekspozohesh ndaj avujve të merkurit, është jashtëzakonisht toksik. Mërkurin, para 2-3 mijë vjetësh, kur ngatërroheshin zorrët, njerëzit e merrnin, e pinin dhe u shqiteshin zorrët. Nuk kishte probleme që mund të shkaktonin vdekje, por produktet kimike të mërkurit, metil-etil-mërkur, janë jashtëzakonisht toksike.

Nivelet e përmbajtjes së tyre të peshqit, në përgjithësi, në analizat që kemi bërë edhe në gjirin e Vlorës, megjithëse peshku është migrator dhe nuk jeton vetëm këtu apo atje, nuk janë shqetësuese për banorët. Kështu që mund të hanë peshq pa mbarim. Gratë shtatzëna sigurisht që duhet të bëjnë kujdes, ndërsa jetëgjatësia e mërkurit, kur është në sediment, për shkak se ai është inert dhe shpeshherë po kaloi në formën e sulfurit të mërkurit është jashtëzakonisht i patretshëm, nuk është biodisponibël. Forma biodisponibël është kur kalon në format organike. Mund të më plotësojë edhe Linda, në qoftë se ka ndonjë gjë shtesë.

Niko Peleshi – Dakord.

A ka pyetje apo diskutime të tjera? Nuk ka.

Kalojmë në votim në parim. Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e konventës së Minamatës “Për mërkurin””? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Diskutimi dhe votimi nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord në tërësi me projektligjin “Për ratifikimin e konventës së Minamatës “Për merkurin””? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Shumë faleminderit!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA